



KATJUSHA
POGAÇI

*Fjala
jonë*

poezi

3111-1
P80.

Katjusha
Pogaçi

FJALA
JONË

poezi

SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

PARTI

Me ty më të gjera
na janë përmasat
e kohës, të këngës,
të dashurisë dhe fjalës.

Me ty më të thella
i kemi rrënjët,
më të pastër sytë,
më tokësore ëndrrat.

Me ty më e lartë
na është qëndresa,
pranvera më e bukur,
më e dashur jeta.

Me ty e ardhmja
është jona,
kemi ty dhe kemi
lumturi miliona.

Kemi ty dhe jemi
si malet në këmbë,
grusht rreth Enver Hoxhës,
rreth Partisë nënë.

KËSHTJELLA JONË

Mbi këtë tokë, në këtë truall
kështjellën tonë kemi ngritur,
pranvera e veson me lule,
dimri nuse e vesh papritur.

Kështjella jonë e bërë prej jete,
mbrujtur prej zemrash, mpiksur me gjak, —
emri liri i rri te balli
dhe emri qëndresë në prag.

Kështjella jonë fole shqiponjash,
vatër legjendash e burim kënge, —
mëngjesi qetë i ulet mbi supe
dhe dielli i qesh nga mëngjesi në mbrëmje.

Kështjella jonë me çati prej dielli,
me dritare të kthjellëta si e vërteta,
me sy të qartë si ndërgjegjja e kombit
nga ku marrin rrugë ëndrra dhe jeta.

J E T Ë

Me jetën jam e lidhur fort,
thellë zembrës e ndiej e në çdo ind,
ato që më lidhin me këtë tokë
janë gjak i gjakut tim.

Në rast dhimbjeje, vështirësie
kur rreh të më pushtojë dëshpërim' i madh,
hedh sytë të ti, Partia ime,
dhe fitoj forcë e bëhem mal.

Nga fjala e nënës te zëri i fëmijës,
nga thinja e gjyshit te pritmënia për nipin,
të gjitha kanë një bosht e një emër — jetë,
me tokën time lidhen dhe me Partinë e shtrenjtë.

SHQIPËRI, SHQIPONJË ME FLATRA

Shqipëri, shqiponjë me flatra,
rrënjëthella, ballëlarta;
moj flamuri kuq e zi,
fillad mëngjesi, Shqipëri.

Shqipëri, zëri me gjëmë,
malet me gjëmim të rëndë,
fushat me fustan si nuse,
zemra jote gjak e kuqe.

Shqipëri, mëmë e Enverit,
djep i madh ku rritet nderi,
zëri yt këngë lirie,
syri shigjetë trimërie.

Shqipëri, hapi me çika,
vajzat dritë e djemt' petrita,
ballin diell, syrin jetë,
Shqipëri, shqiponjë me fletë...

ËSHTE NËNA

Ajo që s'të shkel kurrë dëshirat e dlira,
ajo që gdhin për ty net pa gjumë,
ajo që ëndërron për ty përherë ditë më të mira
ka emrin e thjeshtë e të bukur nënë.

Ajo që të do në ballë të kohës
dhe me sy të ndien gjer skutat e zemrës,
ajo që të thotë të jesh në krah të shokëve
mban emrin e madh e të shtrenjtë të nënës.

ZEMRA JONË

Zemra ime, zemra jote, zemra jonë, shok,
e ndershme është, e ndieshme dhe e fortë.

Për njeriun të madhe e ka dashurinë,
thellë urren gjithë ata që përbuzin lirinë.

Zemra jonë njësh me kohën natë e ditë tik-tak,
në tik-tak rrjedh gjaku i epokave të mëdha.

Ritmi i saj gjeti veten në revolucion
dhe me të dhe për të, shkatërron dhe ndërton.

PO VIJNË LUFTËTARËT

motiv i hershëm

Nga fushë e betejës po vijnë me fitoren,
në ballë e në supe kanë lulëkuqe gjak,
te sheshi i fshatit të gjithë po presin,
zbardhojnë nuset me njomëzakët në krahë.

Si deti dallgët mbajnë tufanet e luftës,
brenda brinjëve në gjoks ajo u troket.
Kush e dha i pari lajmin se po vijnë?
Kush i pari tha: po dal t'i pres?

Fytafyt me armikun, atje tej në brinjë
vranë, derdhën gjak, bënë luftë të rëndë,
një pjesë vjen tani rënduar me armë,
tjetra vjen më pas si motiv në këngë.

DËBORA ERDH PAPRITUR

Dëbora erdh papritur,
flokëbardhë siç vjen gjithnjë.
E vogla vajzë e imja çuditet shumë me të,
se s'e ka parë herë tjetër
dhe s'di se ç'është ajo.
Hundën e vogël te xhami
e shtyp që mirë ta shohë.

Unë rri pranë saj e heshtur,
pranverën mendoj,
kur do shpërthejnë në sytha bulëzat e gjelbra.
Vajza me shoqet do dalë të mbledhë lule fushave
e fjongon e bukur do t'ia marrë era.

PËR SHOQEN QË U BË NËNË

E dashur shoqe, u bëre nënë
dhe ndiej për ty gëzim sa s'thuhet,
të të uroj dua në mijëra këngë,
në jetë të jetëve qofsh nënë e lumtur!

Dhe ja në rrjedhën e ditëve të zakonshme
të erdhi kjo ditë e u bëre nënë,
papritur zbulove që ke aq shumë forcë,
zbulove papritur që je burim me këngë.

Dhe nuk ke ditur që gëzimi i fëmijës
të pushton krejt, përjetësisht të rrit,
se zëri i tij dhe qenia e tij
me vendin, me njerëzit më shumë të lidh.

Dhe nuk ke ditur që shqetësimi për fëmijën
ia kalon dhimbjes së trupit vetë,
se këto gjëra, në dukje, kaq të përditshme,
ta mbushin jetën me më shumë jetë.

Ja drita e jetës të qesh në sy
dhe zëri i fëmijës të çel në zemër,
dhe pulsën atdheut ia ndien më fort,
sepse, si toka, dhe ti ke emrin e nënës.

QAFË E MASHKULLORËS

Qafë e Mashkullorës
për në Panarit,
mbuluar me borë,
mars-dielli ndrit.

Ja atje në majë
ka fole për shqipet,
Qafë e Mashkullorës
hijshëm shpalos brigjet.

QYTETI IM

Kur dita zbardh kalaja shfaq konturet
dhe një grusht mjegulle në sup e tund,
qyteti im — si fëmijëria
në pastërtinë e tij të pafund.

Nën shi vezullojnë çatitë e hirta,
motivet e njohura gjirokastrite gri,
në zemër ky qytet më kthehet në këngë,
në rrugët e tij unë shndërrohem në fëmijë.

Te vallja e kalldrëmit, te sofatet e gurta
hedh sytë dhe ndizen kujtime shumë,
takoj një shoqe, takoj një shok,
dikush më tutje thërret: ej, jam unë.



Kështu të gjithë të dashur, njerëzorë
në këtë qytet të lashtë e të ri,
plot punë e dritë, plot ngjyrë e jetë,
plot të vërtetë e fantazi...

MOTIV NGA LUFTA

Ja, ajo është atje
mes njerëzve,
e heshtur.
Gjithë qenia e saj
duket sikur pyet:
Ku është im bir,
im bir ç'u bë?
Sheh sytë e mi,
buzën plasaritur,
në heshtje
kupton
dhe s'nxjerr zë.
Më merr kokën e lidhur
në duart e saj,
e vë pranë thinjave
pranë shamisë së zezë,

dy buzët e rreshkura m'i vë në ballë
dhe lodhjen harroj,
dhe plagën s'e ndiej.
Në zërin e saj të thellë
rëndojnë malet
dhe zogjtë këngën fillojnë;
pikon diçka
nga dashuria e madhe
dhe nga malli i madh që i rri në gjoks.
E unë dëgjoj fjalën trim.
E unë dëgjoj fjalën lule.
Dhe zëri i saj më bëhet në çast
mëngjes i ndritur,
me ngjyra vezulluese,
edhe më duket se gjuha jonë
nuk ka si bëhet më e mirë,

me fjalët trim,
me fjalët lule:
lule, more trima,
trima, more bij...

REVOLUCIONI

Njësh me diellin, me ajrin, me ujin,
me çdo gjë që ka dhe që jep jetë,
vjen ai, i madhi, i serti njerëzori,
revolucionari i vërtetë.

Vjen, dhe gjëmimi i hapit të tij
ka jetë në hapin proletar.
Bota gatitet që prapë të bëjë
Tetorin e Leninit të madh.

Vjen të shembë me rrapëllimë
gjithë kalbësirat e këtij shekulli,
vullkani i madh i gjoksit të tij
mban djepin e lirisë së përjetshme.

Vjen revolucioni dhe kapitali dridhet,
ngre banda, fashizëm, ushtri e mbret,
nga frika, prej tij, gjakos e tmerrohet
dhe në kllapi godet e bërtet.

Nga frika prej tij, antirevolucionarët,
ata që në deje kanë ujë e jo gjak,
si merimanga shpejtojnë të shpërndajnë
teorinë e komunizmit fals.

Tmerrohen prej tij gjithë kalemxhinjtë,
ata që teoritë i derdhin lumë,
dhe që më shumë se vdekjes i tremben
marrjes së pushtetit me dhunë.

Dhe qesh revolucion i madh i vërtetë
me gjoksin e tij sa katër horizonte,
qesh e pyet: «Ç'do të thotë «bashkekzistencë»,
ç'do të thotë, vallë, rrugë paqësore?

Që të humb e të bie në letargji
të shtrohem, të bëhem qilim me lule
nën këmbët e zonjave, të zotërinjve,
qafën dhe shpinën ta ul si të buajve.

Po unë jam revolucion, nuk jam kolltuk,
ju zotërinj, këtë s'e kuptoni?
Unë jam dhunë, pushtet, diktaturë
dhe që të vij, s'kërkoj lejë nga fronti,

YLIBRE BIBLIASHI

se fronet tuaja unë i përmbys,
i shkul me rrënjë, nga dheu i fshij,
në maja të larta proletarin, e ngjit
dhe fron për njerëzimin bëj veç Lirinë».

YLBERE BILIBASHI

Emri yt një grusht pranverë
harkuar mbi male e në zemra,
ti u lidhje plagët shokëve,
moj e vogla, moj e ëndërrta.

me dhjetë gishta aq të hollë,
me dy sy, moj, aq të butë.
Bora e ashpër dhe e ftohtë,
gjaku yt-ylber i kuq.

Emri yt si hark ylberi,
vitet shkojnë — ai i gjallë,
dhe përgjaket emri yt në këngë,
përgjaket mbi borën e bardhë.

N Ë N Ë

Më të bukura me ty bëhen
rrugët,
qyteti
dhe kalldrëmi i vjetër.
Hapat e tu në zemër më kumbojnë
dhe kjo pak poet më bën patjetër.

Mes punëve e mendimeve
të shumta,
mbyll një ditë si bijë,
si nënë hap një ditë tjetër,
për ty gjej kohën një rresht të këndoju
dhe kjo pak poet më bën patjetër.

MINATORËT

Me pistoleta mbi shkëmb dhe në gjoks,
diçka i japin dhe i marrin tokës.
Në ballin e tyre rri i ndezur
mendimi i madh i kohës.
Thellë galerive shkëmbi dridhet,
dërrmohet nga forca e tyre,
kjo do të thotë se revolucioni ecën
dhe bllokadat thyhen.

NË DITËT E NËNTORIT 1944

Po vinte liria si drita e pastër,
në zemrat e ndezura ia ndienim hapin,
që qe e jona këtë e dinim,
e atyre që ranë dhe e atyre që e prisnin.

E kishim pritur të mëdhenj e të vegjël,
vendi i djegur e i varfëruar,
si bukën dhe si dritën e diellit,
si toka e fharë pret për ujë e për t'u lëruar.

E kishim pritur në shekuj mes rrugës së vështirë
dhe ja mes grykës së pushkës na erdhi.
Lufta jonë dritë iu bëftë te sytë,
gjaku ynë iu bëftë përjetësi në deje!

ZELIHA ALLMETËS

Legjendat thonë: të bukurat e dheut
dilnin dhe fshiheshin prapë në liqen;
ti u fute në lumin e vërshyer
nënë dhe grua
e dole heroinë që andej.

Legjendat thonë: të bukurat e dheut
në ujë fshihnin bukurinë prej njerëzve;
ti, Zeliha
je nëna më e bukur,
se dy fëmijë
ia hoqe nga thonjtë vdekjes.

Atje ku re ti
vala e bardhë e ujit
u ngrit, u ngrit në lapidar,
(si nga shkëmbi i Argjiros) —
për të gjithë fëmijët
vetmohimi yt pikon qumësht të bardhë.

NË DITËLINDJEN E VAJZËS

Në ndriçimin e ditës dhe vezullimet e mbrëmjes
gjej diçka nga pamja jote,
diçka nga kaltërsia e bukur e syve
dhe nga faqja me gropëzën e vogël në qoshe.

Në rrjedhën e lumit, në dritën e diellit
shoh diçka nga pamja jote,
diçka nga fluturimi i përgjysmuar i fjalëve
dhe nga hija e vijës së lakuar të flokëve.

Në zemrën time prej nëne ti je
e gjithëpushtetshme, nga qenia jote
buron mendimi i ëmbël se po rritesh ti
dhe dëshira e mirë të më bëhesh shoqe.

NA RRTI SOCIALIZMI

Na rriti socializmi, na bëri gra të mëdha
dhe jetën na e mbush me diell,
thjesht dhe pa bujë i çelim mëngjeset,
siç u lajmë fytyrën e përgjumur fëmijëve.

Na hoqi perçen nga sytë e na dha dritë,
na hoqi prangat nga zëri, nga zemra
dhe hapin na e bëri të çeliktë
dhe ninullat na i bëri kaq të ëmbla.

Në rrugën e tij e ndërtuam vetveten,
bllokada thyejmë dhe mposhtim natyrën,
këndojmë për të renë, shkelmojmë të vjetrën,
përkrah shokëve në një hap me socializmin.

Të gjitha në një këngë mblidhemi,
në një këngë së bashku kuvendojmë,
kjo është, o shoqe, bota e zërit tonë,
është bota e ëndrrës sonë.

NDARJA ME SHOQEN

Shoqja ime
me një fustan ngjyrë qielli,
me të qeshurën si zambak i bardhë,
ka sy të bukur si deti.

Tundet kordelja e saj e lehtë
në këtë mëngjes të freskët maji,
qerpikët pulit para syve të kaltër,
vërtet një det i tërë mbyllet e hapet.

Po ikën,
tund dorën dhe trazon një copë hapësirë,
hedh sytë dhe trazon një copë deti,
lë dhe merr një mal me dashuri...

PËR SHOKËT BRAZILIANE*)

Ratë po gjakun ua thithi toka juaj
(kështu ndodh me të rënët kudo),
gjaku juaj rreh në damarët
e gjithë revolucionarëve,
e gjithë atyre që sot nga zemra
këndojnë internacionalen.

Ratë në betejën e madhe
e u kthyet në besim,
ratë në fushën e luftës së klasave
e u kthyet në himn.

*) Kushtuar shokëve Pedro Pomar, Anhele Arrojo dhe Huan Batista Drumond, vrarë mizorisht, në dhjetor 1976, nga reaksioni fashist.

Jetën tuaj e merr të rritë shtatin
liria,
jetën tuaj e bën ëndërr fëmija,
që akoma i mungon buka,
i mungon libri e drita.

Jeta juaj dhe ne na e mpreh mendimin
(kështu ngjet kudo me revolucionarët)
dhe na tregon se e bëjmë mirë rrugën e vështirë,
se e bëjmë mirë qëndresën e madhe.

1977

KËNGË PËR PARTINË

Sikur të donim të bënim portretin tënd, Parti,
me duart tona,
me mendje,
me zemra,
vallë si do ta gdhendnim gjithë këtë stuhi,
si do t'ia bënim portretin nënës.

A do të mund t'i vinim dot siç janë
vitet e tu, diej në gjithësinë e revolucionit?
Ne duam t'i gdhendim të gjitha,
të gjitha,
me duart
e me zemrat tona.

Ku t'i daltojmë gjithë këto tufane?
Duhet male të tëra...
Merr malet e përpjekjeve tona vigane
dhe zemrat tona, skulptorja histori,
për portretin e shtrenjtë të Partisë nënë.

Merr
jetën diellore që na prarohet në zemra,
gëzimin që kemi në sy,
rreth gushës së vajzave
shaminë e aksionit,
në çdo cep të saj — një glob lumturi.

...

Partia lindi,
djepi i kohës ish i ashpër,
ajo u rrit
si vazhdim i maleve të larta drejt diellit
dhe në qoftë se ndonjë degë harron rrënjët e
kalbet,
ajo e pret dhe vetë më lart ngrihet.

A të kujtohet, shok,
si traktet e Partisë
i ngjitëm lart te dielli dhe në ballë të shtëpive?
Mëngjeseve rrezet e tyre na ranë në dritare,
na ranë në fytyra,
në zemra.
Partia na thoshte
me ato rreze:
«Qepini yjet në ballë,
lidhni plagët e rënda!»

Këngët partizane i kishim në buzë,
si rrugë që na çonin te liria;
në shpatullat e këngëve malet marshojnë,
mbi këngët dhe malet
Partia.

Kolonat partizane,
lule djem e trima.
Mbi dëborë ndrit ende gjaku i marshimit,
fryn erë e kohëve
dhe trëndelina nga jelekët e nënave
na vjen
bashkë me aromën e bukës së misrit.

...

Ja, vitet e tensionit në bllokadë,
alarmet,
gjumi i ndarë më dysh,
rrudhat e thella
dhe thinjat e bardha
në ballin e shtrenjtë të Partisë.

Revizionistët,
tinzarë, si gjarpërinj, na vërtiteshin,
plot dredha, të errët...
Ku e kishin kokën dhe bishtin ku e kishin?
Partia shikonte në vitet që e prisnin,
Partia hapte shtigje të reja.

Dhe me vargmale, Parti, i shkrove fjalët,
vargmalet e fjalëve në zemra na rrinë:
«Ne bar hamë, po kurrë s'i shesim,
as nderin,
as lirinë».

Të ecim, të ecim
lindnin fjalët në gojën e maleve...
Në gojën e fushave mbinin...
Dhe qytetet tanë të fortë e të pastër
thellë nëpër deje ndienin
trokitjet e zemrave tona,
si trokitjet e së ardhmes.

...

Të tillë e ka portretin Partia:
yll i kuq në kohën tonë të madhe,
ndaj s'do të na thyhen armët kurrë,
s'do të na tremben në buzë fjalët.

Koha mban vesh,
flet Partia ime...
Gëzuar, shokë,

shëndeti i revolucionit,
shëndeti i së ardhmes!

Partia dëgjon rrahjen e zemrës së vet dhe mat
pulsin e epokës,
Partia pjek ëndrrat tona dhe kalit të ardhmen,
Partia...

LABËRISHTE

Buçet një këngë, këngë Labërie,
dhe tundet në ajër shamia e bardhë,
dridhet një valle e rëndë pleqërishte
dhe ndiej hapësirë, ndiej gëzim të madh.

I dëgjoj pleqtë kur mblidhen e flasin
e tundin ngadalë flokët thinjëbardha,
kohët e para kur zënë e ngasin,
gjurmë që kanë lënë në male, në ara.

Më pëlqen të rri midis grave labe
e t'i bëj iso këngës labërishte,
labushkat në këngë nga bota e madhe
derdhin male, vesë, diej e lëmishte.

Ti ia merr aq shtruar, zëri, moj, t'u thaftë,
që si rrezja çan bardhësinë me re,
ti ia kthen aq bukur, si rrjedh' e kristaltë,
lule, more trima, që ratë për atdhe!

Më pëlqen të shoh vallen burrërishte
si përplaset këmba bramë në dysHEME
dhe rrjedh djersa ballit kur ia kthen me grykë:
kjo tokë është jona, të saj jemi ne!

RRETHIMET NUK NA MPOSHTIN

Çel jeta e re, zbardhon si agimi,
paçka se rrethimi çdo ditë përgjon,
paçka se gjithnjë vë veshin të matë,
pulsin dhe syrin që vigjëlon.

Rrethimi është i fortë, rrethimi është tinzar,
pak qetësi kërkon, pak frikë dhe pak heshtje
dhe një të çarë të vogël për të të varrosur
në honin ku zgjohen ish-klasat borgjeze.

Krah shqiponje ne, gjoksshtrënguar me malet
rreth kalasë së pamposhtur, rreth mëmës Parti.
Kala një popull midis tufaneve,
kala ky popull në stuhi.

Jemi të mëdhenj siç jemi dhe të thjeshtë
në fjalë, në jetë dhe në rrethim,
dhe bukës i themi bukë e gjethit gjeth
dhe ujkut i themi ujk e jo qengj.

Edhe fëmijës që në djep i mësojmë
marshin e madh të luftës së klasave
dhe vetes i mësojmë se është jetë
të qëndrosh fitimtar mes bllokadave.

Kështu midis shokëve tanë të thjeshtë
dashuria lulëzon e çel bisqe hareje,
me Partinë në zemër, me të ardhmen në sy,
me socializmin thellë në deje.

Socializmi, kënga jonë e dashur,
në ballë të poezive e të këngëve, Partia;
na qesh buza kur lulëzon ftoi te pragu,
na ndrit balli ku skuq e bukur liria.

NË NJË PASDITE VJESHTE

Dy fëmijë të vegjël nën një pullaz
soditin shiun vjeshtor që lag perëndimin e diellit,
trungjet e pemëve duken të kuqërremtë e të butë,
nga qerpikët — gjethe u rrjedhin lot gëzimi.

Fëmijët përplasnin duart e qeshin nën pullaz,
dhe fluturojnë tingujt e zërave të tyre të çiltër,
shiu u ka lagur këpucët, pantallonat,
perëndimi i diellit fytyrat u ka ndritur.

Ky muzg i qetë, ky fillim vjeshte
me shiun e shtruar e të ngrohtë
kanë nevojë për këta fëmijë e për këtë qeshje
siç kanë nevojë për ngjyrat tablotë...

KUR VJEN 8 MARS

Vjen 8 Marsi,
vjen pranvera
dhe te pemët lulet ndizen.
Ne na ngjan, në duart tuaja
marrin rrugë të katër stinët.

Vjen 8 Marsi,
vjen pranvera,
te fëmijët u qeshin sytë,
shih si u është mbushur zemra
plot me këngë dhe me plot dritë.

Vjen 8 Marsi,
dhe për ju
në dyqan për lule kthehen.
Lule ju, te luftë e madhe,
lule ju, te këngë e djepit.

N Ë A G I M

Dielli i tundi rrezet e para
si tingujt e bukur të fjalës mirëmëngjes,
dhe, si vajza që kreh gërshetat,
i derdhi në krahërorin e hirtë të maleve të sertë.

Dërgoi rrezet si lajmëtare
të ndrisin dritare, pemë e fletë,
synë e zjarrtë ia nxjerr malit te shpatulla,
gjallërojnë e zhurmojnë të gjitha foletë.

Malet ngjatjetojnë njëri-tjetrin,
qeleshet e bardha i vënë pak mënjanë,
i lajnë sytë me një grusht rreze
dhe retë i shtyjnë për rrugë të gjatë.

Dritaret hapen, erdh dita e re
me tingujt e gjerë të fjalës mirëmëngjes,
më e bukur ngjan fytyra e vajzës
dhe djali më serbes.

NË MUZG

Dielli po perëndon.
I qetë, madhështor
rrezet e fundit mbledh
nga kreshtat e maleve,
vezullon mbi supet e tyre të rëndë,
pastaj dalëngadalë
u humbet
prapa shpatullave.

Ikën
duke tundur rrezet e fundit
atje në qiellin e muzgët,
(si dora e njeriut të dashur
tutje
larg në kthesë),

me një telegram diellor
përskej buzëve:
«na prisni, vijmë nesër në mëngjes».

ISHE VAJZË, U BËRE NUSE

Ishe vajzë
u bëre nuse,
u bëfsh degë
plot burbuqe.
Erdhe pak
e u bëfsh shumë,
moj zambak i bardhë
në ujë.

Erdhe ti
u mbush shtëpia,
plot lule
çeli qershia.
Nëpër fshat
e rreth e rreth
shoqe ke,
brigada pret.

FËMIJËT E SHKOLLËS SË DEÇANIT

Mirëmëngjes, Shqipe,
mirëmëngjes, Besa,
mirëmëngjes, Kreshnik,
mirëmëngjes, Jeta,
mirëmëngjes, Donika,
mirëmëngjes, Krenar,
mirëmëngjes, Teuta,
mirëmëngjes, Bledar.

Gjyshi jua tha
përrallën e vjetër,
gjyshi jua tha
përrallën me keca,
gjyshi jua tha
përrallën me çifte,

përrallën me bajlozin që rri te dera.
Pa hapni sytë, mëngjesi po vjen
dhe dielli syrin te mali e nxjerr;
nëna do vijë t'ju marrë në krahë,
babai lart do t'ju hedhë.

Pa çohuni, fëmijë,
pa merrni çantat;
ja, fusni abetaren,
këndimin, lapsat.

Dhe rrugën nisin,
dhe zemra u rreh
nga A-ja në B,
nga C-ja në E.

Ku është mësuesi,
mësuesi ynë
që e këndon aq bukur të madhin Naim?
Fëmijët sytë i hapin,
pyesin në heshtje,
sikur përmbysin dy pikëpyetje,
dhe zemrën e njomë diçka e trondit
dhe rrugën marrin me vërtik.

Ata vrapojnë.

Era fryn,

një këngë për Bajram Currin

në gojë u fërshëllin,

një këngë për Isën,

një këngë për Shotën.

Me krahët e vegjël ata shtrëngojnë gjithë botën,

mëngjeset me diell,

pranverën e bukur,

ditën e re me sy të sigurt,

ditën që thellë u rri në dej,

si këngë majekrahi,

ohej!

RETË E BARDHA

Retë e bardha në shtëllunga
vijnë e ikin prapë,
dielli lindet, perëndohet —
bëhet ditë e natë.

Del një bisk i ri në ftua
dhe bajamja çel,
lule e bardhë bie mbi ëndrra,
ëndrra ngjyra merr.

NINULLE

Nina-nana fli, moj xhane,
të bën nëna partizane.
Nina-nana fli, moj shpirte,
të rrit nëna komuniste.

Mbushur kopshti plot me lule,
mbushur deti pulëbardha,
fli se yjt' në qiell flenë,
fli, moj dritë, nina-nana.

Kur ti sytë e bukur mbyll,
fryn një fllad e zbardh një re,
zogjt' ndër pemë njëri-tjetrit
i thonë hesht, se ti po fle.

Mbylli sytë e rrite shtatin
se rrënjët i kemi thellë,
është një nënë që na rrit
dhe kjo tokë që na ushqen.

Nina-nana fli, moj xhane,
të bën nëna partizane.
Nina-nana fli, moj shpирte,
të rrit nëna komuniste.

SHOQES

Ti e di, nga dhimbja jote
edhe zemra ime 'dhëmb,
kjo nga dashuria vjen, moj shoqe,
kjo nga ndjenjë e mirë vjen, s'do mend.

Për një fjalë ne kot nuk trishtohemi,
për një fjalë s'ndahemi gjithsesi,
ngjarjet e mëdha të kohës sonë
rrinë tek unë, rrinë dhe te ti.

Dhe kështu në zemër dashuria
është e fortë, paçka se nuk shpërthen,
e mos u çudit që ndonjëherë
dhe te fjalë e ashpër udhë gjen.

Kjo i bën të shterin fjalët boshe,
ndjenjat zhvesh nga çdo kotësi,
një bisedë shoqesh për punë mode
jashtë ndiesive të vërteta rri.

Ndaj dhe shoqëria s'është e thjeshtë,
dhe e lehtë s'është kurrsesi,
të mendosh për shóqen si për veten
ke dyfish shqetësime, dyfish lumturi.

NJATJETA, DITË E RE!

Njatjeta, ditë e re!
Ti je jona,
me emrin tonë në buzë ti zgjohesh,
në sy të shohim
e forcë të japim,
nga sytë tanë dritë të japim,
me zërin tonë të japim jetë
që të jetosh në qindra vjet.

Fytyra jote shikon te dielli
i ëndrrave të bukura,
i shpresave të mëdha, —
gjen vetveten zemra te zemra,
te shoku, te fjala vëlla.

BISEDE ME VAJZËN TEK URA E RROGOZHINËS

E shikon ti, e shtrenjtë bija ime,
këtë urë mbi të cilën treni trokon?
Mami yt këtu ka punuar dhe natën
e nga skela thërriste: «Shpejt beton!»

Te fusha, më tej, ishte sektori
me fjetore, me mensa, me sallën e leximit,
barakat prej pupuliti qenë të thjeshta
dhe ne vullnetarët të thjeshtë ishim.

Në një mbasdite prilli binte shi,
lageshin traseja dhe barakat tona,
Lili këndonte në sallë një motiv të ri,
ne u nsëm për betonimin e urës, në orë të vona.

Punuam gjithë natën dhe lodhjen e shtynim,
një shoqe që lart na flste: eheeej,
shikoni si fle hëna në djepin e Shkumbinit!
tej zbardhte mëngjesi pranveror, transparent.

Dhe ti, kur të rritesh, do shkosh në aksione.
Ku? Në çdo skaj të Shqipërisë,
shumë këngë do këndosh me shokë e shoqe
dhe vepra të tjera do ngrini, natyrisht.

SI MUND T'I THUASH

Si mund t'i thuash fëmijës:

«Rri urtë!»,

si mund t'i thuash:

«Mos dil jashtë!»

kur vetë kujton me mall
sa herë ke përpjekur kërcinjte
gur më gur në fshat.

Si mund t'i thuash fëmijës:

«Pusho!»,

si mund t'i thuash

«Hesht!»,

si mund t'i thuash të të lëjë rehat,
të të lëjë të bësh një vjershë?!

SI MUND T'I THUASH

Si mund t'i thuash:

«Mos u trazo me shokë
e baltë mos zër me dorë!»,
pastaj të bësh një vjershë për vërsnikët
dhe për rrugët e largëta
që të çonin në shkollë?!...

Si mund t'i thuash

«Tasho»

Si mund t'i thuash

«Hesht!»

Si mund t'i thuash të të lësh veshat

të të lësh të bësh një vjershë!

DIÇKA KREJT E RE

Kjo ditë më thotë se je afër
nën këtë qiell të madh e të pastër,
në qytetin tim me rrugë të gjata
ku trafiku s'ndalet.

Pritja shfaqet me mall e me heshtje,
pak nota lirike të ketë mbrëmja,
dritat ndizen nga skaji në skaj
të ngrohta, të shumëngjyrta,
të ëmbla.

Nga ajri i dridhshëm, nga gjethet e lehta,
nga mijëra pëshpëritje njerëzore përreth
e ndiej se ka diçka të përjetshme dhe krejt të re
te kjo buzëmbremje, te kjo pritje e qetë.

KORRIERI

Hapin përmbi borë
majave me erë,
pishat tundin shtatin,
malet kokat ngrënë.

Pishat shtatin tundin,
pishat krahët hapin,
duket se thërrasin,
hej, shpejtoje vrapin.

Vrapi nuk të ndalet
maleve me borë,
letra të djeg gjoksin,
zemra krahërorë.

Letra është e bardhë
e shkruar me bojë,
fjalët janë si rrënjët
që rrinë nën borë.

Ndaj ti shpejton hapin
pranvera të vijë,
rrënjët të shpërthejnë,
dhe bora të shkrijë.

Po plumbi të merr
në shpatull, në ijë,
mbi borën e bardhë
lulëkuqet mbijnë.

U ule ngadalë,
malet përçark,
si dorë nëne pishat
të lëmojnë ballë.

Hej, korrier, vrapo,
pishat kokën ulin
sikur lot lëshojnë,
sikur të përkundin.

Hej, korrier, vrapo
si dhe djalëria,
që të vijë pranvera,
që të vijë liria.

Kush të merr në krah,
kush në gji të ngroh?
Dashuri e shokëve
në çdo anë buron.

Vallë ç'ke në gji,
vallë ç'të ka mbetur?
Letrën që atëherë
koha s'e ka tretur.

Dhe pse re te pisha,
dhe pse re te mali
vrapi kurrë s't'u sos,
vrapin kush s'ta ndali...

N Ë P I C A R

Eci në rrugë mes njerëzve të mi
që kanë si dhe unë fytyrë të qetë,
që lë ngjasimet e saj të qarta te fëmijët
e i thërret ëndrrës e mendimit
të kenë dritë e jetë.

Eci në viset e tokës sime malore,
mësuar me të e rritur prej saj,
me ftohtësinë e ujit të gurrës së shpejtë,
me qeshjen që në zemër më jep lulja në maj.

Eci dhe rritem njeri mes njerëzve...
Njeriu i thjeshtë ka në shpirt poezi,
kur tregon me lirizëm për tufën e deleve
dhe si të hidhte hopa kur ti ishte fëmijë.

Njeriu i thjeshtë që ti e do e të do,
(të lidh dashuria e madhe, atdheu,)
ngryset ballin e shpërthen në urrejtje të thellë
që nëndetëset e huaja turbullojnë Mesdheun.

Jam bijë mes njerëzve të mi të vendlindjes,
zakonmirët, punëshumët, bujarët,
të duan punëtór, të duan të ditur,
të lidhur me njerëzit, me grurin, me arën.

NË GUASKËN TËNDE TË VOGËL

Brenda në guaskën tënde të vogël
mendon se si ti s'ka të aftë e të zotë,
mendon se je më i mirë nga shokët,
ngaqë tavolinën e mban me libra plot.

Në vetminë tënde të vogël
njerëzit të duken pa vlerë,
të duken krejt si gogla
ata që tokën punojnë në dimër, në verë.

Pa ata asgjë s'do të kishte kuptim
se pa ata ty do të të mungonin të tëra
që nga skrivania me librat për lexim
deri te shtrati i butë e te sheqeri i ëmbël.

Pa ata ti je kështu krejt i vogël,
me ta ti bëhesh njeri i vërtetë
dhe njerëzit dhe vetja të duken më të mirë
ndonëse për të do mendosh më thjeshtë.

RINIA JONË

Duke pritur
të bien lulet e pranverës e të lidhen frutat
bëjmë sërish shaka
me flokët dhe qerpikët e lagur nga shiu,
paçka se koha shkon
dhe fëmijëria iku.

Nga pragu i shtëpisë,
nga loja me kukulla
erdh dita kur ndiem ç'ndodhte rreth vetes.
U bëmë gra, u bëmë nëna,
burim i pastër i jetës.

Duke dashur
prapë të shohim
si lindet lulja kur ndërrohet stina,
papritur ndiejmë tek mbijnë mes flokëve
dhe zënë vend të parat thinja.

Megjithatë
asgjë nuk ndodh,
nuk ka mërzi, tronditje s'ka,
atë që jeta na kërkoi
secila me gëzim ia dha.

Atë që koha na kërkon,
në netë pa gjumë, me vetmohim,

DALJËNGADALE PO VJEN

s'pyesim pse rrudha na mbulon
s'pyesim pse thinja po na lind.

U bëmë gra, u bëmë nëna
burim i pastër i jetës,
megjithatë te bijtë tanë
rininë e kemi lënë të ndezur.

E madhe është rruga e jetës,
e madhe dhe rinia jonë,
se jemi gra dhe jemi nëna,
burim i dashurisë gjithmonë.

DALENGADALE PO VJEN

Ky dimër i rëndë
bën të dalë e s'del,
pranvera si nuse
bën të vijë e s'vjen.

Do dal ta gjej vetë,
do dal vetë ta sjell
pranverën e presim
po ajo pse s'vjen?

Bora e bardhë,
fashist i zi;
në çdo pikë gjaku,
pranverë, të mbjellim ty.

Nusja mënd fëmijën
në gjoksin si borë,
bajonetë e hasmit
tokën tonë e shpon.

Nën pullazin tonë
botë e madhe ndrin,
në çdo pikë gjaku
çelim shteg për ty.

Unë me yll në ballë,
ajo, bar e gjeth, —
pranvera si nuse
dalëngadalë po vjen.

PRILLI

Prilli hyri
me lirizmin e tij në buzë të këngëve tona,
me hijeshinë e tij në sytë e njerëzve tanë,
me ngrohtësinë e tij në gjelbërimin e jetës.

Hyri,
dhe me duar e shtyu dimrin e bardhë,
natyrisht ngadalë që mos ta lëndojë,
shko të flesh tani, baba i madh,
derisa të vijë ora të të zgjojmë.

Erdha unë, prilli krahëlehti,
që zgjoj në zgjua zukatjen e bletës
e shtoj në bisk një lule të hollë,
të bukur, që lind frytin e jetës.

Erdha dhe ndeza në ara xixëllonjat,
në rrugë ndrijnë neonet dhe hëna,
me lulëkuqe ju fal mijëra kurora
siç thurin fëmijët e vegjël për nënat.

FËMIJËRIA JONË

Fluturon
në viset e ngrohta prindërore
dhe na lë në zemra
kaq dashuri.

Te ti merr formë fytyra jonë,
nis rrugën jeta për t'u bërë njeri.

KAM QENË DIKUR FËMIJË

Vise të dashura
të fëmijërisë,
vite të largëta
pikë e nga një pikë.
Guva me buronjat,
zallishtet dhe rrapet,
mali plot legjenda
të reja e të vjetra.
Gjyshja me përqafimin gjithnjë të ngrohtë.
Të qeshur,
të menduar
dy sy fëmijërorë,
gjithçka për të parë,
gjithçka për të kapur,
gjithmonë xixëllues,
por dhe të përmbajtur.

KAM GJË DËKUR PËMIR

Çdo gjë të madhe
ta shndërronin në ëndërr,
çdo gjë të vogël ta bënin kala,
sa pylli
sa lumi,
sa mali përballë.
Ecët e ecët e erdhët këtu,
eci e eci e s'vij dot te ju.



ZË I LASHTË

Duke lexuar baladën e murosjes

Më murosën në gur,
në kala më murosën,
trupi im i ri pranë gurit rri,
gjaku im me gurin si të zërë miqësi?!
Lashë djalin të vogël, lashë djalin të bukur,
djepin kush ta tundë, qumësht ku të pijë?

Kënduan gratë shekujve me radhë
në këngët e vajit,
në këngët e dasmës;
më patën aq pranë,
më patën aq larg,
po kurrë s'më harruan brenda gurit të ashpër.

Dhe shpesh ju kam thirrur me qetësinë e natës:
ejani, motra, m'i hiqni këta gurë
që më prishën ëndrrën dhe ballin e bukur,
më këputën jetën,
zërin
edhe gjumin.

Jam me gurë ngarkuar, po qëndroi zemra,
mes gurëve rënduar lule shkrepit kënga.
Në buzë të jetës
për djalin — tri fjalë,
mbi gur të kështjellës
qumështi rrjedh i bardhë.

Vitet ikën larg,
koha ime pas,
zemrën e kam nderur
te një këngë e lashtë.

E shtrirë mes gurit
syrin kurrë s'e mbyll,
te rreshti i baladës
jeta shkrep si yll.

VATRA E NDEZUR

Vatra zjarrin e mban ndezur,
vatra zjarrin nuk e shuan,
nga brezi në brez e përcjell
të kuqe si gjaku e ruan.

Dhe hi kur i hedhin,
kur duan ta mbulojnë,
ajo shkëndijëzën në zemër e ka,
me të miliona shkëndija ndez
deri në flakët e mëdha.

VITET E PARTISË

poemë

Gjithë jetën me Partinë në gji,
me dritën dhe me diellin e saj
në sy,
hapi ynë në hapin e revolucionit,
gjëmon si stuhi.

Me kraharorin e gjerë sa shekulli
një këngë të re çdo vit i thur jetës,
me fytyrën dhe zërin e veçantë të tij,
në mesazhin e madh të së vërtetës.

Si gurët e fortë në kështjellën e madhe
që ngremë me mund, që ngritëm me gjak,

të gjithë e rinuan fytyrën e nënës,
të gjithë bashkë në një barrikadë.

Të gjithë me dritën e ndezur më 8 Nëntor,
ku zuri fill rruga e tyre
vite të thjeshtë e madhështorë,
me një flamur e me një yll mbi krye.

Të gjithë te njëri-tjetri sup më sup qëndrojnë
në çdo kohë, në bllokadë, çdo moment në furtunë
dhe njëri-tjetrin në sy drejt e shikojnë,
ngarkuar me rini dhe me dritë shumë.

Vite me flamurin e shtrenjtë të atdheut,
me të qeshurën e mëngjeseve pranverorë,
me cicërimën e zërit të kalamajve tanë
që iu mbushin çdo minutë kraharorë.

Vite me gurgullimën e vrullshme të jetës,
me vërshimin e gjakut të kuq në damarë,
vite mbushur me punë e përpjekje,
të gjithë bashkë vite — komisarë.

Me këtë emër në gji stafetën njëri-tjetrit
ia dhanë të pastër nga skaji në skaj,
nga lufta e madhe e gjaku për liri
nga Ballshi te Fierza, nga Fierza në Koman.

Nga kooperativa e parë te hekurudha e parë,
te qytetet e reja, te lodrat për kalamaj,
nga minierat e thjeshta te metalurgjiku i madh,
nga rrëkezat e vogla në uragan.

Partia në ballë që kur rrugën nisëm
nga qindra halle — në botë të re,
si dielli që rri në zemra,
si zemra që mbush me jetë.

* * *

Na rritet kënga e jetës në zemra,
të mëdha i kemi për të nesërmen ëndrrat,
të lidhura me njerëzit tanë,
me atdheun,
me ty, Parti,
që ngrihesh mbi çdo këngë,
mbi çdo poezi.

Rreth vetes na mblodhe si vëllezër
na bashkove, na bëre çelik,
dhe paskëtaj u bëmë një,
çdo një nga ne u bë të gjithë.

Se ti na ndien çdo rrahje zemre,
çdo thinjë, çdo rrudhë na kupton,
se ti me ne je në çdo dhimbje,
në çdo gëzim dhe në çdo front.

Këto vite të mëdha, vite tufane,
me përpjekjet tona si masivë të rëndë,
dhe zemrat tona si këngë të së ardhmes
në zemrën e dashur të Partisë nënë
janë jeta jonë...
e reja dhe e bukura,
kur në ballin e kufitarit
ndrin e puthura
që buzët e nënës e lanë si yll...
në jetën e vajzave rrugët e aksionit
dhe ëndrra e tyre — një botë lumturi.

Ja malet dhe fushat, e gjithë Shqipëria
fluturimi i shqiponjës përjetësisht me flamur,
horizontet e reja që çeli Partia
nga rruga komuniste deri te një ninullë.

Kishin mbirë luftërat
dhe fëmijët s'i linin
të uleshin te pragu
të këndonin një këngë,
se zërin e bukur ua trembte armiku
dhe këngën përgjysmë ua linte plumbi.

Kur donin të na hiqnin buzëqeshjen nga buzët,
në vatrat tona me njerëzit tanë
u ngrit Partia në luftë të madhe
t'u priste rrugën luftërave që na vranë.

Në vatrën tënde të ngrohtë, atdhe,
kërkuam dhe gjetëm shkëndijën për liri,
të bukur, të ndritur në zemra e kishim
kur nisëm rrugën me ty, Parti.

Partia lindi, ish kohë e ashpër,
kërkonin ta mbysnin, kërkonin ta flaknin,

kërkonin ta vishnin me rrobe tjetër,
ta bënin të ecte në rrugë të vjetër.

Kështu atëherë, kështu më pas,
kështu armiqtë gjithmonë,
por lindi ajo në zjarrin e madh
lindi përjetë të jetojë.

Lindi ajo në zemra të reja,
me botë të re, me gjak të ri,
kjo shumë do të thoshte për vitet e ardhshme,
shumë do të thoshte për ty, Shqipëri.

Lindi ajo nga dashuria jote e madhe,
Shqipëri qesh siç qesh nëna,
Enver Hoxha në ballë si malet
me diellin e marksizmit në rrëmba.

* * *

I shkruam traktet e para të Partisë,
pas tyre ëndrrat lindnin:
të lindësh ëndrrën e madhe të lirisë
e bashkë me të të rilindësh.

Të krijosh një këngë
për tokën,
për vete,

lirisht të thuash një fjalë,
kjo është, o shokë, rruga jonë e vetme
ky është ideali ynë i madh.

Shtëpitë e vogla kala — istikame,
shtëpitë e vogla salla kongresesh,
për to s'pyetëm gjakun që rridhte plagëve,
sfiduar madhërisht torturat e egra.

Që dyert të hapeshin si zemra e nënave,
që dyert të lidheshin me njëra-tjetrën varg,
që shokët komunistë të hynin, të dilnin,
Partia të rritej, të hidhte shtat.

Që trakti të shkreppte
në mure,
në shkallë,

në dritaren e zemrës të hynte
dhe bota të çelte e madhe paskëtaj
dhe njeriu ynë i madh të rilindej.

Të thjeshtët djem,
të thjeshtat vajza
me emrin e bukur
ilegalë,
nga dera në derë,
nga lagjja në lagje,
në zemrën e kombit
u ngritën lapidarë.

Kështu ecëm me besim
drejt botës së re
me një kapotë lufte, me hap partizani.
Partia njerëzit s'i mati nga guna, —
nga pushka, nga gjaku i mati.

Kështu në ato dhe në vitet që vinin
përballë çdo armiku,
momenti
a kohe,

qëndresa kish hyrë në çdo qelizë,
ish bërë për kombin shtyllë kurrizore.

S'ishte e lehtë të mposhtje armiqtë,
s'ishte e lehtë të qëndroje,
po shqiponja nuk di të ecë ndryshe,
di vetëm të fluturojë.

S'ishte e lehtë të zhdukje nga vetvetja
ato që errësira me egërsi i mbolli,
s'ishte e lehtë në vorbullën e kohës
fytyrën tënde të re të ndërtoje...

Të hapje një udhë,
të ngrije një vepër
me vrull rinor, me hov për ndërtim,
të guximshme i çelëm ëndrrat për jetën
Partia u dha dritë,
u dha forcë e ndriçim.

Në këmbë të gjithë, Promete të vërtetë,
pishtarë për shokët tanë proletarë,

paçka se armiqhtë rreshtonin me tërbim
bllokada të egra dhe rrethime varg.

Revizionistët e egër
vërdallë na vinin
me fjalët — thika,
me llogaritë e zeza
shqiponjës krahët e çeliktë t'i prisnin,
shikimin e mprehtë t'ia bënin të verbër.

Ju s'keni naftë,
ju s'keni bukë,
ç'ju duhen uzinat,
elektrifikimi.

Partia mendohej:
pa to vuan populli,
Partia mendohej:
kështu s'ka thënë Lenini.

Jo!
Ne rrugën tonë e kemi të qartë,
askush s'na ndalon,
askush s'na kthen,

ajo forcë që na jep jetë e krahë
është thellë në ideal,
në gjakun tonë e gjen.

Kjo ishte kënga jonë e re
shikimi i pastër, ritmi i ecjes,
kjo ishte thirrja jote e madhe,
ky ishte refreni i qëndresës.

Dhe fushat pjellore
dhe malet krenare
në krahë si shokë i kishim,
dhe ecnim ne,
ti në ballë çaje
si çan shqiponja mes stuhive.

Ti na shtjelloje situatat,
të vërtetat na thoshje
dhe horizontet buzëqeshnin
nga djersa jonë flladitur
e ne shikonin ç'ish bërë Shqipëria,
sa lart, Parti, na kishe ngritur.

Ecnim
e në zemrat tona ndienim

gjakun tënd si rrihte me vrull.
Ti sytë i mbaje në horizontin e trazuar
duart' thellë të zëna në punë.

Ecnim

e në ecje ndienim peshën e viteve
e bashkë me të forcën e rritjes.

...

Dhe prapë rrethime,
dhe prapë bllokada,
dhe prapë kërcënime,
dhe prapë lajka,
ca fjalë të pakuptueshme,
ca paragrafë,
gatuar në punishtet me zift e me natë
të revizionistëve të rinj e të vjetër, bashkë.

Po mbi të gjitha këto ndrit një fytyrë
në formë shqipeje që çan në stuhi,
po mbi të gjitha ngrihet një zë,
një zemër rreh:
Popull - Parti.

* * *
Kur vjen Nëntori
ditën e tij

të parë
të madhe
në fllade festash e hap ai.
Në palë flamuri krahët rrahin
vitet e ardhshme të Shqipërisë

Partia flet
me gjuhën e fitoreve.
Partia flet
me gjuhën e trimave,
për revolucionin
dhe për komunizmin,
për ju shokë barrikade
kudo që jeni.

Partia flet dhe çelin mijëra këngë,
Partia ngre dorën dhe mijëra grushte ngrihen,
Partia hedh sytë dhe mijëra shpresa ndizen.

Partia këngë në zemrën e çdonjërit,
thirrje në zërin e së vërtetës,

Partia mëngjes i ditëve që vijnë,
ngjyra dhe shija e jetës.

Partia betim në barrikadën e luftës,
gjak dhe forcë në zemrën komuniste,
e jona Parti

 në ballë të furtunës,
e jona në ballë të stuhive.

Partia betim i madh i së ardhmes
nga buzët e plakut

 te fëmija i mitur,
Partia diell i viteve të ardhme,
Partia jonë
 e ndritur.

PËRMBAJTJA

	Faqe
Parti	3
Kështjella jonë	5
Jetë	7
Shqipëri, shqiponjë me flatra	8
Është nëna	10
Zemra jonë	11
Po vijnë luftëtarët	12
Dëbora erdh papritur	13
Për shoqen që u bë nënë	14
Qafë e Mashkullorës	16
Qyteti im	17
Motiv nga lufta	19
Revolucioni	22
Ylbere Bilibashi	26
Nënë	27

	Faqe
Minatorët	28
Në ditët e nëntorit 1944	29
Zeliha Allmetës	30
Në ditëlindjen e vajzës	32
Na rriti socializmi	33
Ndarja me shogën	35
Për shokët brazilianë	36
Këngë për Partinë	38
Labërishte	44
Rrethinat nuk na mposhtin	46
Në një pasdite vjeshte	49
Kur vjen 8 Marsi	50
Në agim	51
Në muzg	53
Ishe vajzë, u bëre nuse	55
Fëmijët e shkollës së Deçanit	56
Retë e bardha	59
Ninullë	60
Shoqes	62
Njatjeta, ditë e re!	64
Bisedë me vajzën tek ura e Rrogozhinës	65
Si mund t'i thuash	67
Diçka krejt e re	69
Korrieri	70
Në Picar	73
Në guaskën tënde të vogël	75

Faqe

Rinia jonë	77
Dalëngadalë po vjen	80
Prilli	82
Fëmijëria jonë	84
Kam qenë dikur fëmijë	85
Zë i lashtë	87
Vatra e ndezur	90
Vitet e Partisë (poemë)	91

Pogaçi, K

Fjala jonë. Poezi. [Red.: R Vozga]. T.,
«Naim Frashëri», 1983.

108 f.

(B. m.) dhe

(B. v.): 891.983-1

P 80

Tirazhi: 1500 kopje Formati 70x100/32 Stash: 2204-79

KOMBINATI POLIGRAFIK Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1983